

Migrimi i dytë

përpiluar nga redaktorët

Rrugët migruese të romëve vlah | Arritja në Evropën perëndimore | Amerikat | Pranimi i endacakëve në vendet e synuara

➤ Në mesin e shekullit të 19-të, ndodhi një lëvizje e dytë migruese, i cila ndryshoi popullatën rome në gjithë botën. Kalderash, Lovara dhe grupet tjera rome nga Evropa qendrore dhe jug-lindore lëvizën drejt lindjes dhe perëndimit dhe madje arritën në Amerikë dhe Australi. Ky migrim i dytë, i ashtuquajtur pas valës së parë të migrimit romë në Evropë rreth vitit 1400, ishte shkaktuar nga ndryshime të mëdha shoqërore, veçanërisht me shfuqizimin e skllavërisë në Wallachi dhe Moldavi, dhe shfaqjen e industrializimit.


PARATHËNIE

Në 1857, një vit pasi që skllavëria ishte shfuqizuar tërësisht, në Wallachi tani ekzistonin 33,267 familje të lira rome; 6,241 nga to kishin qenë skllavër të shtetit, dhe 12,081 skllavër të Kishës. 14,945 familje kishin qenë pronë e fisnikërisë. Në Moldavi, ekzistonin rreth 20,000 familje. Nëse secila familje përbëhej prej një mesatare je prej 5 anëtarëve, atëherë rreth 250,000 romë jetonin në dy principatat. Në tërë Evropën qendrore dhe jug-lindore, kishte një popullsi rome me fuqi të konsiderueshme.

Revolucionet politike, ekonomike dhe sociale shkaktuan emigrimin nga ai regjion që nga viti 1850 e më tej. Lëvizjet nacionale për emancipim, luftërat, revolucioni industrial si dhe tërheqja e ngritur e vendeve të synuara sikurse Shtetet e Bashkuara ishin arsytet që njerëzit e të gjitha grupeve etnike të braktisnin zonat e tyre të banimit. Romët nuk kishin më shumë “dëshirë të emigronin” sesa grupet tjera të popullsisë. Por shfuqizimi i skllavërisë në Moldavi dhe Wallachi hapi territore të reja në kërkimin e tyre urgjent për vende të reja atraktive ekonomike. [III. 2]

Kryesisht, romët emigruan nga zonat kufitare të Moldavisë dhe Wallachisë, si dhe regjionet fqinje

RRUGËT KRYESORE TË MIGRACIONIT TË DYTË III. 1



Zonat e origjinës: ■

të Bessarabia, Transilvania perëndimore, Banati dhe Serbia veri-lindore. Më vonë, ekzistojnë dëshmi të emigrimit të romëve nga gati i tërë gadishulli Ballkanik, dhe rrjedhimisht edhe nga Hungaria dhe Sllovakia. Kryesisht

romët Vlah, por edhe romët nga grupet tjera lëvizën në lindje drejt Rusisë, dhe në veri drejt Skandinavisë, Evropës perëndimore, Amerikës veriore dhe jugore dhe madje edhe Australisë. [III. 2]

ROMËT “VLAX”

III. 2

Shprehja “vlox” (e shqiptuar: vlah) është përdorur që nga shekulli i 20-të për romët, gjuha e të cilëve tregon një ndikim të fuqishëm Wallachian (Rumun). Romët Vlah përbëhen, në mes të tjerëve, nga Kalderash, Lovara, Gurbet dhe Xhambaz-Romë. Romët Vlah konsiderohen si nxitës dhe udhëheqës të Migracionit të Dytë. Në shumë vende synuese, ata rrinin ndarazi nga romët tanimë të vendosur dhe krijuan një shtresë të re brenda popullatës rome.

Shkenca, si dhe vetë përfytyrimi i romëve Vlah, shpesh i konsideron ata grupe arkaike më “tradicionale” sesa ato që mbanin një gjuhë dhe kulturë kryesisht indo-ariane. Mirëpo, Angus Fraser, historiani romë britanik, katërhequr vëmendjen për faktin se këto supozime nuk mund të konsiderohen si të dëshmuara.



III. 3 Gratë Kalderash në marshin për Angli, 1911.

(nga Fraser 1992, f. 232)

RRUGA PËR Suedi E JOHAN DIMITRI-TAIKON

“Carl Herman Tillhagen mund të tregojë për origjinën e Taikonit suedez, familjen e tregimtarit të famshëm Johan Dimitri-Taikon:

Deri në vitin 1906, Taikon ose Milosch, emri i tij Cigan, duket të ketë qëndruar kryesisht në Rusi, të cilën ai e njehe nga Baku në juglindje deri në Archangelsk në veriperëndim. Në vitin e njëjtë, ai udhëtoi për në Ballkan, dhe Poloni e Finlandë. Ai duket të ketë qenë, kalimthi, gjithashtu në Itali, Austri, Çeki, dhe Gjermani. Disa vite para Luftës së Parë Botërore ai vizitoi Suedinë, ku udhëtoi për shumë vite. Ai i kaloi 30 vitet e fundit vetëm në Suedi, ku fitonte jetesën e tij dhe të familjes si bakërpunues, artist i panairëve dhe muzikant. Që nga viti 1942 ai dhe shoqëria e tij kanë qëndruar në Suedi çdo vit gjatë dimrit.”

III. 4 (përkthyer nga 1983, f. 61)

RRUGËT MIGRUESE TË ROMËVE VLAX

Kalderashët rumun konsiderohen si grupi më lëvizës i romëve. Si skllëvër, ata i përkisnin shtetit, që do të thotë, se ata kishin qenë (pjesërisht) nomadë dhe kishin ushtruar profesionin e tyre duke u endur nëpër disa regjione. Kalderashët u larguan nga zona përmes dy rrugëve kryesore. Njëra i shpinte në veri, tjetra në Ballkan, veçanërisht në Serbinë e sotshme; nga atje, shumë romë lëvizën edhe më larg drejt perëndimit. Migrimi i Kalderashve dhe grupeve tjera në Ballkan nuk është i dokumentuar, veçanërisht sa i përket fillimit të tyre. Me gjasë kjo ndodhi diku kah fundi i shekullit të 19-të. Mirëpo, ekzistojnë shumë dëshmi për rrugën drejt veriut.

Në vitin 1860, Kalderashët e parë arritën në Krakov, që në atë kohë ishte në territorin e Austro-Hungarisë. Duke qenë qytetarë austriak, shumë romë nga Transilvania dhe Banati kishin dokumente austriake të udhëtimit

në dispozicionin e tyre. Specialisti rus i gjuhës Romani, Lev Tcherenkov, përmend se Kalderashët madje edhe në ditët e sotme quhen “Ostrijaki” (Austriak) nga Romët e vendosur Polak. Disa imigrantë të rinj në Poloni u përpoqën të arrijnë një pozitë dominuese në mesin e romëve tanimë të vendosur; familja Kwiek madje themeloi një dinasti të “mbretërve”.

Shumë Kalderash dhe Çurara lëvizën nga Polonia për në Rusi dhe Skandinavi. Işvan Demeter, një nga imigrantët e parë romë në Rusi, disa dekada më vonë tha se familja e tij emigroi kryesisht për shkak të prikave të mëdha për femra. Demeterët udhëtuan përmes Rosisë, arritën në Mançuri dhe më vonë qëndruan në Rusinë qendrore. Babai i Işvanit dhe familja e tij madje arritën në Algjeri. Grupi i Işvan Demeterit nuk ishte rast i izoluar. Për shembull, shumica e Kalderashve në Francë nuk kishin arritur para vitit 1870, por imigruan më vonë nga Rusia. Dialekti i tyre tregon fjalë nga të folurit shoqëror, që është një shenjë e qartë që

duhet të kenë qëndruar në Rusi më parë. [III. 4]

Shumë Kalderash dhe Çurara lëvizën më tutje drejt Skandinavisë. Rrjedhimisht, kushërinjtë e Işvan Demeter u vendosën jo vetëm në Francë, Itali dhe Gjermani, por edhe në Suedi. Emrat e familjeve gjithashtu dëshmojnë se shumë imigrantë suedezë së pari kishin qëndruar në Rusi.

Në gjysmën e shekullit të 19-të, Lovara u vendosën në kufijtë e sotshëm hungarez, në Transilvani dhe Banat. Në valën e parë të migracionit, në vitet 1860-70, Lovara lëvizën nga Hungaria për në Çeki dhe Sllovakia, dhe pastaj në Gjermani. Disa nga ta iu bashkëngjitën ushtrisë në luftën Austro-Prusiane dhe u vendosën në Çeki para se përfundimisht të shkonin në Austri. Të tjerët shkuan në Poloni dhe më vonë në Rusi. Bredhjeve të grupeve të ndryshme Lovara iu erdhi fundi vetëm në vitin 1914, pas shpërthimit të Luftës së Parë Botërore; ishte një fund i përkohshëm, sepse gjatë Kryengritjes Hungareze në vitin 1956, një numër i Lovara shkuan prapë në Austri.

SHKATHËTËSIA E LAVDËRUAR, ÇMIME TË FRYRA

“Derisa sa ishin në Britani ata sollën një pjesë të madhështisë orientale në zonat e shkreta të qyteteve të zymta. Femrat, me monedhat e arit të thurura në gërshetat e flokëve të tyre dhe të lidhura rreth qafës dhe kraharorit, paraqitnin një spektakël admirues, shumë i ndryshëm nga homologët e tyre anglez në zbukurimet e tyre [...]; dhe meshkujt, në pantallona të gjera të futura në çizme, me këmbisha me ngjyra të ndezura, dhe pallto e jelek me vargje të pullave të mëdha të argjendit (disa po aq të mëdha sa një ve pule) ishin po aq të shkëlqyeshëm. Shumica e kohës së meshkujve harxhohej në kërkimin e enëve të bakrit për t'i riparuar në fabrika, punishte birre, hotele, restorante, dhe të ngjashme: shkathhtësia dhe mjeshhtëria vlerësoheshin në masë të madhe; çmimet e fryra në po aq masë të madhe kundërshtoheshin.”

III. 5 (nga Fraser 1992, f. 231 ff.)



III. 6 Tendat e Kalderashve në Garratt Lane, Wandsworth, Londër në gusht 1911. (Fraser 1992, f. 231)

IMIGRIMI NË KOLUMBI

Në vitin 1998, një romë kolumbian informoi për emigrimin e paraardhësve të tij:

“Romët evropian emigruan në Amerikën qendrore, nga Amerika qendrore ata emigruan në Amerikën jugore, ata erdhën në Peru, ata erdhën në Brazil, ata erdhën në Kolumbi. [...] Ata emigruan përmes Panamës, nga Panama ata kaluan Atraton dhe shkuan në Antioquia [...] në fushat e Bogotës, në bregdete, në pjesë të ndryshme. Sipas romit kolumbian, kishin kaluar 150 deri 160 vjet që nga koha kur ata kishin lindur këtu në Kolumbi. Pasi që gjyshi im kishte vdekur në moshën 75 vjeçare, e që kishte lindur në Kolumbi, gjyshja ime, tani e vdekur, gjithashtu kishte lindur atje.”

III. 7 (përkthyer nga Deman, Katharina (2005) Untersuchung zur Grammatik der Romani-Varietät der Kumpanja in Bogotá/Kolumbien. Graz (Phil. Diss), f. 11)

ARRITJA NË EVROP ËN PERËNDIMORE

Disa romë erdhën me pasaporta austriake, me gjasë nga Transilvania, përmes Gjermanisë dhe Belgjikës në Francë në vitin 1866, por shpejt u dëbuan prapa në Belgjikë. Në vitin 1867 Kalderashët udhëtuan rreth Francës në grupe prej 30, 40 dhe madje 150 njerëzve në qerre të hapura kuajsh. [III. 4]

Në vitin 1868 Kalderashët arritën në Angli. Ata vendosën tentat e tyre në periferitë e Londrës, por nuk u pranuan në mënyrë miqësore nga romët anglez. Në po atë vit, bakërpunuesit Kalderash u shfaqën në Holandë. Tentat dhe vagonët e tyre, si dhe kontrasti në mes të rrobave të tyre të vjetra dhe argjendit dhe arit të shfaqur haptas, lanë një përshtypje të madhe tek popullata. Me mijëra prej tyre, ata u mbloodhën në kampet e tendave, dhe romët madje mund të kërkonin pagesë për hyrje. Në fillim të viteve 1870-ta romët erdhën në Francë nga Italia dhe

Gjermania— përmes Ballkanit ose Rusisë. Ata gjithashtu tërhoqën një grumbull të vizitorëve. Në Gjermani, në vitin 1867, dhe në Holandë në vitin 1868, trajnuesit e arinjve u shfaqën për herë të parë; ata ishin romë Ursari nga familjet Gulabavich, Lazarovich ose Mitrovich. Në vitin 1886, 99 Kalderash arritën në Liverpool. Ata erdhën nga Greqia, pjesët evropiane të Turqisë, nga Serbia, Bullgaria dhe Rumania. Vitin e ardhshëm ata prapë braktisën vendin. Në vitet 1885-7 dhe 1907-8 Ursari qëndruan në Skotlandë jugore dhe Anglinë veriore. Mirëpo, në veçanti ishin Lovara, të cilët përmes Gjermanisë, arritën në Angli në atë kohë. Mediat dhe policia udhëhoqën fushatat kundër romëve me pasaporta gjermane. Veprimet e ngjashme u ndërmorën në Francë, Gjermani, ose Zvicër. Në mes të viteve 1911 dhe 1913, familjet Kalderash të quajtura Choron, Kirpach, Demeter ose Maximoff udhëtuan rreth Britanisë në trena me tentat e tyre, të cilat tërhoqën vëmendje të madhe. [III. 3, 5, 6]

AMERIKAT

Vetëm disa romë të cilët arritën në Britani të Madhe qëndruan aty. Shumica e tyre shkuan në Amerikë, duke qenë një pjesë e valës së madhe të migracionit evropian. Romët të cilin ishin dëbuar atje në shekujt 16-të dhe 17-të nuk kishin lënë gati asnjë gjurmë. Mirëpo, të ardhurit e rinj shkaktuan që vendet si Argjentina ose SHBA të lëshonin ndalim hyrje për romët në vitet e 1880-të.

Në fillim, nga viti 1850 e më tej, ishin kryesisht “Romanichels” britanik, të cilët shkuan në Shtetet e Bashkuara. Me kohë, një grup i ri u shfaq, duke qëndruar ndarazi nga pjesa tjetër e popullsisë, e cila ishte specializuar në zanatat shëtitëse si tregtia me kuaj, bakër punimi ose thurja e shportave. Në vitet e 1880-të, emigrimi në Amerikën veriore dhe jugore ndryshoi në mënyrë drastike. Gjithnjë e më shumë evropianë jugor dhe qendror erdhën në SHBA, nga Perandoria Austro-Hungareze, Italia, Turqia, Greqia, Rusia dhe Rumania.

Në mesin e tyre kishte një numër të romëve, siç ishin Rudari nga Bullgaria në vitin 1882 dhe grupet e muzikantëve hungarez-slovak në vitin 1883; këta të fundit formuan korin e “Bashaldé”, sot të njohur si muzikantë në tërë SHBA-në. Rudari ishin performues në cirk, artistë dhe trajnues të kafshëve me majmunë dhe arinj. Ata e shpallnin vetën austriak, serbë ose turq, që praktikisht përfshinte tërë zonën e Ballkanit në kuptimin e asaj kohe. Gjithashtu, një grup romë nga Maçva Serbe, sot të quajtur “Maçvaja”, arritën në SHBA. Shumë romë erdhën në SHBA përmes Kubës, Kanadës, Meksikës ose Amerikës Jugore, prej nga emigrimi ishte më i lehtë. [III. 6]

Popullata rome e Amerikës Latine sot përbëhet nga përafërsisht 2.5 milion njerëz, dhe gati në mënyrë të përkryer pasqyron lëvizjet migruese që nga viti 1850. Grupet më të mëdha janë prapë Kalderash dhe Lovara, si dhe ish Calé spanjolle. Sinti që jetojnë në kontinent janë një dëshmi e imigrimit në mes të luftërave botërore, dhe dëshmojnë se migrimit romë i kishte ardhur fundi vetëm përkohësisht në vitin 1914.

PRANIMI I ENDACAKËVE NË VENDET E SYNUARA

Në shumicën e vendeve të Evropës perëndimore mbretëronte qetësia si i përket romëve. Kjo ndryshoi befasi me ardhjet e reja dhe përfundimisht rezultoi në probleme edhe për romët në pozitë dhe të vendosur. Për shembull, autoritetet holandeze filluan të kërkojnë me nxitim për mënyrat se si t'i hiqnin qafe romët e emigruar, që secilën herë bëhej më e vështirë për shkak të rregulloreve gjithnjë e më shumë të ashpra në vendet fqinje, posaçërisht në Gjermani. Sinti lokal shpesh vuanin nga klima gjithnjë e më shumë armiqësore.

Në vitet e 1850-të, ligjet më rigorozë anti-“Cigane” gjithashtu u miratuan në Bavari. Në fund të shekullit kjo shkaktoi që romët e vendosur – kryesisht Sinti – të zhdukeshin gati tërësisht nga vetëdija publike, ndërsa grupet udhëtuese, të cilët kryesisht konsideroheshin hungarez ose gjerman të pastrehët, çdo herë e më tepër u bënë të dyshimtë. Në përgjithësi besohet se

ata përdornin tregtinë me kuaj dhe muzikën si maskë për lypje të lëmshës, vjedhje dhe krime tjera.

Në Austro-Hungari, sikurse edhe në Perandorinë Gjermane, migracioni shkaktoi ndryshime substanciale në “politikën Cigane”. Emigrimi shihej si një “pushtim” nga autoritetet, të cilat prapë rezultuan në shtimin hap pas hapi të ligjeve. Kufizimet masive në udhëtimet e tyre, rregullat më të fuqishme për profesionet e tyre dhe tentimet e para për regjistrimin e romëve iu morën atyre bazën e jetesës, të cilat programuan telashet me pjesën tjetër të popullsisë.

Në Angli, ekzistonin disa projektligje përmes të cilave jeta e romëve vihej nën kontrollin e shtetit për qëllime edukative. Mirëpo, parlamenti i hodhi poshtë këto ligje në formën e tyre të menduar dhe të ashpër. Në Serbi, “nomadizmi” ishte i ndaluar, në Francë, “Ciganët” u regjistruan në vitin 1907, në Suedi u urdhërua një ndalim i përgjithshëm për emigrimin e romëve, Argjentina tanimë e kishte bërë këtë në vitin 1884, e përcjellë nga SHBA në vitin 1885.

PËRFUNDIM

Vala e dytë migruese e romëve në mënyrë drastike ndryshoi popullatën rome në shumë vende. Në Amerikën Latine ose Australi popullata rome u

krijua vetëm nga kjo valë e migracionit. Edhe pse rrugët e vështira të emigrimit do mund të rikrijoheshin për disa grupe dhe shumë familje të vetme, edhe pse rruga kryesore e migracionit do të mund të përcillej,

ne jemi larg nga përshkrimi adekuat i kësaj lëvizjeje të ndërlikuar migruese. Historia e saj ndërlikohet dhe e tërësishme ende duhet të hulumtohet.

Bibliografia

Crowe, David M. (1995) *A History of the Gypsies of Eastern Europe and Russia*. London / New York: I. B. Tauris Publishers | **Fraser, Angus (1992)** *The Gypsies*. Oxford / Cambridge: Blackwell | **Marushiakova, Elena / Popov, Veselin (2001)** *Gypsies in the Ottoman Empire. A contribution to the history of the Balkans*. Hatfield: University of Hertfordshire Press. | **Saló, Matt T. / Saló, Sheila (1986)** *Gypsy Immigration to the United States*. In: *Papers from the Sixth and Seventh Annual Meetings, Gypsy Lore Society, North American Chapter*. New York, pp. 85-96 | **Tcherenkov, Lev / Laederich, Stéphane (2004)** *The Rroma. Volume 1. History, Language and Groups*. Basel: Schwabe Verlag | **Vossen, Rüdiger (1983)** *Zigeuner. Roma, Sinti, Gitanos, Gypsies zwischen Verfolgung und Romantisierung*. Frankfurt am Main: Ullstein

